

VENDIM
Nr. 15/2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 3, DATË 16.9.2009 “PËR ÇAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, të neneve 55 pika 1 dhe 21 pikat 1 dhe 2 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, pas marrëveshjes së Kryetares së Kuvendit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 3, datë 16.9.2009 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

I. Deputetja Mesila Doda largohet nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe caktohet anëtare në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

II. Deputeti Luan Skuqi largohet nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat dhe caktohet anëtar në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

III. Deputeti Rrahim Çota largohet nga Komisioni për Integrimin Europian.

IV. Deputetja Arenca Trashani caktohet anëtare në Komisionin për Integrimin Europian.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar në datën 21.3.2012